


**MBROJTJA E  
TË DHËNAVE  
PERSONALE**

**STRATEGJIA  
2018-2020**

**E DREJTA  
PËR  
INFORMIM**

**NJOFTIMI  
DHE  
KONSULTIMI  
PUBLIK**



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE**

<b>MESAZHI I KOMISIONERIT</b> .....	3
<b>I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM</b> .....	4
1.1 Misioni i Zyrës së Komisionerit .....	4
<b>II. E DREJTA PËR INFORMIM</b> .....	6
2.1 Situata Aktuale .....	6
2.2 Zbatimi i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” .....	7
2.3 Vizioni dhe Qasja .....	8
2.4 Objektivat .....	9
Objektivi 1: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut .....	9
Objektivi 2: Konsolidimi i kuadrit ligjor .....	10
Objektivi 3: Përmirësimi, trajnimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i autoriteteve publike .....	13
Objektivi 4: Forcimi i statusit të autoritetit mbikëqyrës .....	14
2.5 SFIDAT .....	15
1. Transparenca në partneritetin publik-privat .....	15
2. Rritja e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike .....	15
3. Garantimi i një sistemi efikas i të dhënave të hapura ( <i>open data</i> ) .....	15
<b>III. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE</b> .....	16
3.1 Situata Aktuale .....	16
3.2 Vizioni dhe Qasja .....	17
3.3 Objektivat .....	18
Objektivi 1: Përshtatja e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me rregulloren 679/2016 e BE-së GDPR dhe direktivën e policisë 680/2016 .....	18
Objektivi 2. Rritja e kapaciteteve të stafit të zyrës së komisionerit në kuadër të harmonizimit të legjislacionit me acquis .....	21
Objektivi 3: Bashkëpunim dhe partneritet me homologët e vendeve të BE, KE dhe institucionet shtetërore ..	22
Objektivi 4. Mbrojtja e të dhënave në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit .....	22
Objektivi 5: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe kontrolluesit publik dhe privat mbi risitë e ligjit të ri të harmonizuar .....	23
Objektivi 6: Edukimi i nxënësve me të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientet digjitale .....	24
3.4 Sfidat .....	25
1. Identifikimi i praktikave më të mira dhe trajnimet .....	25
2. Krijimi i kulturës së mbrojtjes së privatësisë në ambientet digjitale .....	25
<b>IV. VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE</b> .....	26
1. Konferenca Evropiane 2018 e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale .....	26
2. Konferenca Botërore 2019 e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale .....	27
<b>V. MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA</b> .....	28
Transparenca dhe informimi i publikut .....	29
<b>VI. FINANCIMI I STRATEGJISË</b> .....	29

## MESAZHI I KOMISIONERIT

Zyra e Komisionerit ju prezanton Strategjinë për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për periudhën 2018 – 2020.

Kjo Strategji përshkruan objektivat tona kryesore, ndërkohë që misioni ynë vazhdon për rritjen e transparencës së autoriteteve publike, garantimin e të drejtës për informim si dhe përshtatjen e legjislacionit tonë aktual për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e re të BE-së e cila hyn në fuqi në maj 2018.

Hartimi i kësaj strategjie u parapri nga një analizë gjithëpërfshirëse, në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, nga përparimi i bërë në këto vite, si dhe nga sfidat me të cilat presim të ndeshemi në të ardhmen.

Me kënaqësi konstatoj se vitet që lamë pas kanë shënuar hapa pozitivë në të gjitha drejtimitet e mësipërme. Përkushtimi ynë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me qëllimin mbrojtjen e të dhënave personale, duke monitoruar përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të tyre, apo dhe lehtësimi i të drejtës për të kërkuar informacion publik duke garantuar rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara qytetarëve, do të vijojë të mbetet ndër angazhimet tona kryesore.

Dokumenti i Strategjisë mban parasysh se shoqëria shqiptare, po evoluon dhe po përgatitet për t'u përballur me zhvillimet teknologjike dhe globalizimin në fushën e të dhënave personale apo dhe me synimet e saj për një administratë të hapur dhe me integritet.

Ne jemi të përkushtuar për të demonstruar vlerat si: ekspertizë, profesionalizëm, transparencë, pavarësi dhe përgjegjësi, në kryerjen e funksioneve tona dhe bashkëpunimit me individët, institucionet publike, organizatat joqeveritare si dhe të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë.

Shpresoj se të gjithë të interesuarit dhe bashkëpunëtorët tanë do të mbështetin procesin e zbatimit të Strategjisë 2018-2020 dhe i ftojmë ata të angazhohen në misionin e Zyrës së Komisionerit dhe realizimin sa më cilësor në vitet në vazhdim të këtij dokumenti të rëndësishëm.

# I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

## 1.1 Misioni i Zyrës së Komisionerit

Strategjia për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2018-2020, përfaqëson dokumentin themelor strategjik të Zyrës së Komisionerit. Është një strategji fleksibël dhe merr parasysh kuadrin ligjor ekzistues dhe atë të pritshëm në përputhje me objektivat që duhen përmbushur për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

Vizioni ynë 2020, është garantimi i zbatimit të rregullave të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këto kushte, prioritet mbetet forcimi i llogaridhënies së autoriteteve publike dhe kontrolluesve publik e privat, forcimi i transparencës, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Gjithashtu, zhvillimet në luftën kundër korrupsionit do të vijojnë të mbështeten nga Zyra e Komisionerit.

Ky angazhim do të përbëjë një tjetër sfidë për institucionin, në rritjen e përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike, për sigurimin e një administrate publike që ofron shërbime me cilësi për qytetarët, institucione transparente dhe nëpunës publik me integritet të lartë.

Në këtë dokument, analiza e përvojës së deritanishme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, problematikat e shfaqura në 3 vitet e para të zbatimit të ligjit mbi të drejtën e informimit dhe njoftimit e konsultimit publik si dhe krahasimi i treguesve në vite, kanë qenë elementë thelbësorë për përcaktimin e objektivave për tre vite e ardhshme.

Këto objektiva janë hartuar në përputhje me kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale të cilat janë të sanksionuara në kuadrin ligjor në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, mbikëqyr dhe monitoron në përputhje me ligjin, të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Qëllimi i punës i Zyrës së Komisionerit bazuar edhe në ligjet e sipërpërmëduara, është garantimi i aksesit në informacion të qytetarëve ndaj autoriteteve publike, njohjes së publikut me informacionin publik, si dhe përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti, të drejtën për informim dhe të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Zyra e Komisionerit, nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit, monitoruar zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe kryerjen e sondazheve. Në përputhje me këtë mision,

veprimtaria e Zyrës së Komisionerit, ndjek dhe zbaton rekomandimet e lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, Raporti i Shtetit i Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare.

Si autoritet i pavarur në monitorimin dhe mbikëqyrjen e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit, ka synuar të konsolidojë dhe forcojë rolin e saj të pavarur mbikëqyrës në të dy këto shtylla të rëndësishme. Me veprimtarinë e saj ndërgjegjësuese, parandaluese dhe sanksionet e vendosura, ka bërë që të ketë rezultate pozitive në veprimtarinë e saj.

Megjithëse ende e kufizuar në staf, Zyra e Komisionerit e ka shtrirë veprimtarinë e saj në të gjithë vendin, duke punuar periodikisht në drejtim të ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve, publikut në përgjithësi, shoqërisë civile e medias, për të identifikuar rëndësinë që merr transparenca dhe privatësia në kohët e sotme, por edhe masat që kërkohet të merren për mbrojtjen e tyre.

Bashkëpunimi ndërkombëtar ka qenë në fokusin e punës së Zyrës së Komisionerit duke i dhënë rëndësi takimeve, anëtarësimeve, raportimeve, por edhe paraqitjes së kërkesave për zhvillime të projekteve të përbashkëta për të rritur nivelin profesional të punonjësve dhe jo vetëm.

Në misionin e Zyrës së Komisionerit bën pjesë edhe shqyrtimi i ankesave në lidhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 146/2014 “*Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*”. Ky ligj zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohen nga organet publike në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse. Pavarësisht se institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij ligji është ministri përgjegjës, ky ligj ngarkon me përgjegjësi edhe Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në trajtimin e ankesave, duke i dhënë të drejtën të kërkojë organeve publike të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve, të zhvillojë seanca dëgjimore dhe në rast shkelje të dispozitave të këtij ligji të propozojë organeve publike marrjen e masave administrative ndaj personit përgjegjës sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.

Bashkëpunimi dhe partneriteti i mirë midis organeve publike dhe publikut në garantimin e transparencës dhe pjesëmarrjen e të gjitha palëve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse do të jetë vizioni i të gjithëve për të arritur avancimin e vendit tonë në rrugën e tij drejt integritimit Evropian.

Realizimi i Strategjisë do të jetë një tregues i performancës institucionale në drejtim të forcimit të rolit dhe pavarësisë së institucionit, të konsolidimit të punës së tij, shkallës së rritjes së profesionalizmit dhe forcimit të kapaciteteve njerëzore.

Zyra e Komisionerit synon të zhvillojë më tej vizionin e saj, të rrisë dhe të garantojë në nivelet e kërkuara zbatimin e dy të drejtave kushtetuese, të japë zgjidhje praktike në kohë reale si dhe të ndëshkojë shkeljet e ligjit.

## II. E DREJTA PËR INFORMIM

### 2.1 Situata Aktuale

Aksesi në informacionin që mbahet apo prodhohet nga autoritetet publike është i një rëndësie thelbësore për mirëqeverisjen dhe demokracinë. Refuzimi i aksesit në informacion publik, çënon të drejtat e individëve për të krijuar pikëpamjen e duhur mbi shtetin dhe situatën e shoqërisë, sikurse parashikohet në nenin 1 pika 2 të Ligjit për të Drejtën e Informimit. Transparenca e administratës publike është një parakusht i domosdoshëm për një shtet të hapur dhe demokratik si dhe për forcimin e shtetit të të drejtës. Njëkohësisht, transparenca ecën paralelisht me integritetin dhe llogaridhënien e organeve të sektorit publik, parashikuar në Nenin 1 pika 3, të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit”. Për këtë arsye, është e dukshme se ky ligj dhe zbatimi i tij duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në Reformën Ndër-sektoriale të Administratës Publike 2015 – 2020 dhe në Strategjinë Anti-Korrupsion 2015 – 2020.

Gjithashtu, transparenca është një parakusht i domosdoshëm në rrugën drejt shoqërisë së informacionit, e cila bazohet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit dhe e promovuar nga Bashkimi Evropian për të krijuar një shoqëri të informuar, e cila mundëson përveç të tjerave, një dialog të përhershëm midis shtetit dhe individëve, në veçanti midis qeverisë, administratës së saj dhe qytetarëve.

Për të përmbushur këto qëllime, nuk është i mjaftueshëm vetëm ekzistenca e Ligjit për të Drejtën e Informimit, por duhet shoqëruar me një ndryshim në kulturën e administratës publike. Çfarë ka qenë jo-publike, duhet të bëhet transparente, çfarë është trajtuar dhe vendosur pas dyerve të mbyllura duhet të diskutohet me dyer të hapura, çfarë ishte jashtë fushës vizuale të publikut dhe përtej interesave të individëve duhet të silllet në vëmendjen e publikut. Thelbi i këtij ndryshimi kulturor konsiston në krijimin e besimit të publikut tek administrata.

Ky ndryshim kulturor duhet të zhvillohet dhe nëpërmjet kontributit të Zyrës së Komisionerit. Prandaj kjo strategji përshkruan se si duhet të menaxhohet ky ndryshim kulturor dhe me të, zbatimi i ligjit.

## 2.2 Zbatimi i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kryhet nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të ligjit si psh. numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna.

Ndërkohë që puna intensive, trajnimet e ofruara si dhe monitorimi i kryer nga Zyra e Komisionerit gjatë dy viteve të para të zbatimit të ligjit të ri për të drejtën e informimit, rritën ndërgjegjësimin e autoriteteve publike përballë publikut.

Zyra e Komisionerit ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm konferencash qofshin ato kombëtare apo rajonale, duke ofruar të gjithë mbështetjen e nevojshme për autoritetet publike. Gjithashtu e drejta për informim është përfshirë dhe në kurrikulën e detyrueshme të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike që ofrohet për nëpunësit civil në periudhë prove, duke synuar që parimet kryesore të transparencës dhe të drejtës për informim të jenë të njohura nga të gjithë nëpunësit e administratës publike.

Gjatë kësaj periudhe Zyra e Komisionerit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankesash.



Lidhur me përmbushjen e detyrimeve që autoriteteve publike i burojnë nga Ligji për të drejtën e Informimit, ka ende nevojë për t’u përmirësuar. Shumica e Autoriteteve publike nuk kanë programe të plota dhe të përditësuara transparence, koordinatorët e të drejtës për informim nuk janë nëpunës civil dhe nuk zotërojnë njohuritë e duhura për kuadrin ligjor dhe rregullator të administratës publike çka sjell që implementimi i këtij ligji të mos jetë në nivelet e dëshiruara. Gjithashtu zbatimi i standarteve më të mira ndërkombëtare kërkon që koordinatorët të jenë të trajnuar dhe të kualifikuar madje të jenë dhe të stimuluar financiarisht.

## 2.3 Vizioni dhe Qasja


Në këtë strategji trajtohen dy të drejta që janë në kompetencat e Zyrës së Komisionerit si: e drejta për informim dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat parashikohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mbrohen me ligje specifike, Ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i cili është miratuar në vitin 2014 dhe Ligji 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, miratuar në vitin 2008.

Vizioni i kësaj strategjie nuk është i kufizuar vetëm në zbatimin e legjislacionit. Ligji për të Drejtën e Informimit, do të përmirësohet si rezultat edhe i procesit të trajtimit të kërkesave/ankesave dhe praktikave më të mira të përfuara gjatë viteve të para të zbatimit të tij.

Gjithashtu, ky ligj duhet të plotësohet me zbatimin e *acquis* të BE-së për të ecur paralelisht me masat shtesë për një transparencë më të madhe në sektorin publik dhe privat. Forcimi i Politikave të të Dhënave të Hapura (Open Data) të Shqipërisë është një nga prioritetet, për të shtrirë të drejtën e informimit në fushën e partneritetit publik-privat.

Një transparencë në rritje nuk ndihmon vetëm përmbushjen e një të drejte themelore të njeriut, por është dhe faktor kryesor në Strategjinë Ndër-sektoriale të Reformës së Administratës Publike dhe strategjisë në luftën kundër korrupsionit, në të cilat Zyra e Komisionerit është pjesë.

Për realizimin objektivave 2018 - 2020, do të ketë një vlerësim të vazhdueshëm të përshtatshmërisë së kapaciteteve teknike dhe njerëzore, dhe do të konsiderohet ndryshimi i strukturës me qëllim forcimin e tyre nëpërmjet qasjeve të mëposhtme:





## 2.4 Objektivat

Objektivat kryesorë për një zbatim të suksesshëm të ligjit si dhe për të mbështetur ndryshimet kulturore të lartpërmendura, janë:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut;
2. Një kuadër ligjor dhe rregullator i konsoliduar;
3. Përmirësim, trajnim dhe monitorim i vazhdueshëm i autoriteteve publike;
4. Forcimi i statusit të autoritetit mbikëqyrës.

Është e një rëndësie të veçantë strategjike që këto objektiva të mund të implementohen së bashku dhe në të njëjtën kohë. Ligji nuk përmbush qëllimet e tij nëse njerëzit nuk shfrytëzojnë të drejtat e tyre apo që autoritetet publike të bllokojnë apo pengojnë këto të drejta apo kur Komisioneri nuk balancon qëndrimet e tij.

---

### **Objektivi 1: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut.**

E drejta për informim është një e drejtë e re në Shqipëri dhe qytetarët nuk janë mësuar ende me ushtrimin e saj. Prandaj pasja e vëmendjes ndaj kësaj të drejte është e nevojshme. Njohja e parimeve të së drejtës për informim është shumë e rëndësishme sepse:

- Rezulton në qytetarë të informuar;
- Mundëson qytetarët të marrin pjesë në çështje publike dhe vendimmarrje publike;
- Kontribuon në kontrollin e administratës publike
- Ndihmon në përmirësimin e administratës dhe performancës së saj.

Është para se të gjithash përgjegjësia e Zyrës së Komisionerit për të bërë dallimin midis:

- Publikut të gjerë,
- Organizatat e shoqërisë civile,
- Gazetarëve,
- Studentëve dhe nxënësve,
- Subjekteve private,
- dhe shumë të tjerë

se cili nga këto grupe duhet të informohet dhe edukohet nëpërmjet

- programeve të trajnimit,
- takimeve apo organizimit të tryezave të rumbullakta,
- konferencat ku prezantohen praktikat më të mira
- përfshirjes në kurrikulat shkollore
- formate të tjera.

Po aq të rëndësishme sa këto forma ndërgjegjësimi, është dhe puna gjithëpërfshirëse në kuadër të forcimit të marrëdhënieve me publikun që përfshin jo vetëm informacion material, por edhe organizimi i eventeve që nxjerrin në pah rëndësinë e të drejtës për informim. Aktiviteti vjetor me rastin e ditës ndërkombëtare të së drejtës për informim është një shembull i mirë i ndjekur nga Zyra e Komisionerit.

Për të vlerësuar të gjitha këto masa dhe aktivitete si dhe për të kuptuar më mirë njohurinë e publikut për ligjin dhe qasjen e qytetarëve ndaj të drejtës së tyre për informim, do të shërbente zhvillimi i një sondazhi mbi këtë çështje. Gjithashtu, organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse të dedikuara për secilin prej target grupeve të mësipërme do të ndihmonte në rritjen e ndërgjegjësimin.

Të gjitha këto përpjekje të Zyrës së Komisionerit duhet të plotësohen edhe nga ana e organizatave dhe institucioneve të tjera, pikë së pari nga media e cila duhet të ketë një kontribut thelbësor në ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut.

Rritja e nivelit të ndërgjegjësimin të qytetarëve është kushti thelbësor për të sjellë në jetë ligjin për të drejtën e informimit. Prandaj, Zyra e Komisionerit e ka një nga prioritetet e saj sensibilizimin e qytetarëve për të drejtën për informim në Shqipëri.

---

## **Objektivi 2: Konsolidimi i kuadrit ligjor**

Ligji “Për të Drejtën e Informimit” nuk ka një traditë të gjatë në Shqipëri. Ky ligj parashikon më shumë transparencë, duke përfshirë ndër të tjera afate të reja, një sistem apelimi, mundësinë për të ri-klasifikuar dokumentet sekrete, vënien në dispozicion të informacionit të pjesshëm,

përdorimin e teknologjisë së informacionit për të vënë informacionin në dispozicion të publikut si dhe caktimin e një koordinatori për të drejtën e informimit.

Qendra për Ligj dhe Demokraci (Center for law and democracy), e cila merret me rankimin e Ligjeve për të drejtën e informimit në botë, e ka renditur ligjin në pozicionin e 6 në botë përse i përket parashikimeve të tij.

Zbatimi i shumë dispozitave të ligjit, ngrenë disa pyetje që janë të vështira për t'ju përgjigjur. Aktet nënligjore mund të jenë gjithashtu të dobishme, por nuk ekzistojnë dhe nuk parashikohen. Prandaj është e nevojshme të punohet në këtë drejtim.

Një mënyrë alternative është hartimi i udhëzuesve duke mbledhur dhe publikuar rastet e shqyrtuara. Për një ligj të ri që synon të forcojë demokracinë dhe integritetin, është e rëndësishme që Zyra e Komisionerit të shfrytëzojë çdo mundësi për ta bërë ligjin lehtësisht të kuptueshëm dhe të zbatueshëm. Ky është një tjetër objektiv i kësaj strategjie.

Rishikimi i ligjit është i nevojshëm, nëse dispozitat e tij kanë përmbushur qëllimet e tyre plotësisht apo vetëm pjesërisht apo kanë qenë jo praktike. Për këtë arsye, ligje të ngjashme në Shtete anëtare të BE-së përmbajnë një detyrim për të kryer një vlerësim shkencor, i cili nuk është në ligjin nr. 119/2014. Gjithsesi, një rishikim i ligjit është i nevojshëm.

Zbatimi i ligjit deri më tani ka treguar se pjesa më e madhe e dispozitave kanë qenë efektive dhe se rregullat po funksionojnë mirë. Ka dispozita të cilat duhen përmirësuar. Ligji duhet të amendohet lidhur me aspektet e mëposhtme:

- Vendimet e Komisionerit duhet të jenë titull ekzekutiv;
- Kompetencat e Komisionerit duhet të përfshijnë të drejtën për të deklasifikuar informacionin “Sekret Shtetëror”;
- Sanksionet nuk duhet të vendosen vetëm ndaj koordinatorit apo nëpunësve të autoritetit publik, por edhe autoritetit publik;
- Ligji për të Drejtën e Informimit, duhet t’i nënshtrohet vetëm dokumentacioni që ka të bëjë me veprimtarinë administrative të organeve të sistemit gjyqësor apo të prokurorisë.
- Statusi i Komisionerit dhe pavarësia e tij duhet të forcohet duke prezantuar një dispozitë tjetër në ligjin “Për të Drejtën e Informimit”.

Një nga objektivat e kësaj strategjie është pasja e një ligji “Për të Drejtën e Informimit” të përditësuar, që plotëson kërkesat e një administrate me llogaridhënie të lartë dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duhet jo vetëm një përmirësim konstant i ligjit, por gjithashtu një zbatim i Direktivave relevante të të drejtës për informim në BE, të cilat Shqipëria duhet t’i transpozojë në legjislacionin e saj kombëtar përpara anëtarësimit në BE. Direktivat relevante të BE-së janë:

- **Direktiva 2003/4/EC**, e njohur si Direktiva e Informacionit Mjedisor, e cila synon të bëjë të aksesueshëm informacionin mjedisor ndaj publikut, edhe me anë të kërkesës edhe nëpërmjet publikimit.
- **Direktiva 2003/98 EC**, e njohur si Direktiva ISP, e cila është një element bazë e strategjisë Evropiane për të hapur Informacionin e Sektorit Publik për ri-përdorim në ekonomi për shkak të potencialit të madh ekonomik, i cili mund të përdoret për të krijuar produkte të reja, biznese dhe punësim. Prandaj, Direktiva synon heqjen e barrierave për ri-përdorimin e Informacionit të Sektorit Publik në të gjithë BE-në.
- **Direktiva 2007/2 EC**, e njohur si Direktiva INSPIRE, e cila është për vendosjen e një infrastrukture për informacionin hapësinor në BE për të bërë informacionin hapësinor dhe gjeografik më të aksesueshëm dhe ndërveprues për qëllimet e politikave mjedisore.

Direktiva e Informacionit Mjedisor dhe ajo e Informacionit të Sektorit Publik mund të zbatohen brenda viteve të ardhshme, ndërkohë që kompleksiteti i Direktivës INSPIRE, nxit një zbatim shumëvjeçar, i cili ka nevojë për më shumë kohë se sa zbatimi i dy Direktivave të tjera.

Sa i përket Direktivës së Informacionit Mjedisor, mund të supozohet e zbatuar, për shkak të ndërthurjes së Ligjit “Për të Drejtën e Informimit”, Ligjit “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe Vendimin Nr. 16 të Këshillit të Ministrave, datë 4.1.2012 mbi “Të Drejtën e Publikut për të marrë Informacion Mjedisor”.

Disa shtete anëtare të BE-së kanë përfshirë në legjislacionin e të drejtës për informim dhe ri-përdorimin e informacionit publik dhe informacionin mjedisor, çfarë e bën më të lehtë për publikun dhe administratën për të zbatuar ligjin. Kjo do të jetë një nga drejtimet kryesore të strategjisë: Zbatimi i Direktivës së Informacionit Mjedisor dhe Direktivës së ISP-së në legjislacionin Shqiptar dhe duke krijuar kështu një akt të vetëm dhe uniform të informimit.

---

### **Objektivi 3: Përmirësimi, trajnimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i autoriteteve publike**

Për të synuar nxitjen e “integritetit, transparencës dhe llogaridhënies se autoriteteve publike”, siç parashikohet në Nenin 1, pika 3 e ligjit “Për të Drejtën e Informimit”, këtyre autoriteteve duhet t’i jepen instrumentat e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e tyre të përcaktuara në ligjin për të drejtën e informimit.

Kjo nuk është vetëm çështje e të diturit kur një informacion i kërkuar duhet të vihet në dispozicion, por është çështje kuptueshmërie se pse përhapja e informacionit publik mund të forcojë shoqërinë dhe mund të përmirësojë administratën publike. Për nëpunësit e administratës të cilët nuk kanë pasur eksperiencë me transparencën, një nivel i lartë transparence do të sillte në një ndryshim thelbësor të mentalitetit.

Prandaj, nëpunësit e administratës publike duhet të binden për përfitimet dhe avantazhet që sjell ligji për të drejtën e informimit.

Për ta sjellë këtë afër me administratën publike, Zyra e Komisionerit, ka krijuar tashmë një dialog me nëpunësit e administratës, i cili duhet të mbahet dhe intensifikohet në vitet ardhshme dhe duhet të mbulojë qëllimin e ligjit, përmbajtjen e tij, të drejtat e individëve dhe detyrimet e autoriteteve publike, pyetjet dhe përgjigjet referuar të drejtës së informimit.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të mbajtur një dialog mbi të drejtën e informimit me administratën publike dhe anëtarët e saj. Çdo mundësi duhet të shfrytëzohet, verbalisht apo me shkrim, gjatë sesioneve trajnuese, ndërkohë që trajtohen ankesat, në rastin e inspektimeve, ndërkohë që komunikohet me koordinatorët, gjatë takimeve të çdo lloji. Faqa zyrtare e Zyrës së Komisionerit mund të jetë një instrument për të mbajtur dialogun dhe gjithashtu revista “Informim dhe Privatësi”, e cila është një botim periodik i Zyrës së Komisionerit.

Zhvillimi dhe zgjerimi i këtij dialogu është drejtim strategjik. Ligji për të Drejtën e Informimit mund të zbatohet në mënyrën e duhur vetëm nëpërmjet marrëveshjeve, dialogut dhe bashkëpunimit të ngushtë me administratën publike.

---

#### **Objektivi 4: Forcimi i statusit të autoritetit mbikëqyrës**

Një ligj i cili garanton një të drejtë, vendos përgjegjësi të reja dhe parashikon sanksione, synon të reformojë administratën, duhet të monitorohet dhe ka nevojë për mbrojtje, mbështetje dhe kujdes. Kjo është përgjegjësia e Komisionerit dhe Zyrës së tij, të cilët duhet të bëjnë balancën dhe të respektojnë parimin e proporcionalitetit.

Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit aspiron të hartojë një politikë mbikëqyrëse më komplekse dhe intensive në lidhje me monitorimin e Ligjit “Për të Drejtën e Informimit” me anë të rritjes së kontrollit mbi aktivitetet e administratës publike në lidhje me garantimin e të drejtës së qytetarëve për akses në informacion. Ky objektivi do të reflektohet në raportet që do të përmbajnë indikatorë të vlerësuar, si numri i ankesave, hartimi i programeve të transparencës, caktimi i koordinatorëve, përditësimi i regjistrave të kërkesave dhe përgjigjeve.

Meqenëse Raporti i BE-së për Shqipërinë ka konstatuar se “kapaciteti i Komisionerit duhet të forcohet”, çështja është se si dhe në çfarë mase duhet të realizohet kjo. Sigurisht, para së gjithash kjo është çështje buxheti, por jo vetëm pasi forcimi i statusit mund të realizohet dhe nëpërmjet forcimit të pavarësisë institucionale, qoftë në raport me buxhetin apo dhe me strukturën organizative të institucionit. Mundësi të tjera duhet të merren parasysh si p.sh zgjatja e mandatit të Komisionerit.

Bashkëpunimi me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare është i rëndësishëm. Vlen për t’u përmendur jo vetëm bashkëpunimi me SIGMA/OECD, me ekspertët e BE-së të anti-korrupsionit në projektin e binjakëzimit, i cili mbulon gjithashtu fushën e të drejtës për informim, por gjithashtu bashkëpunimi me Universitetet në Shqipëri dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Për të garantuar një mbështetje edhe më të madhe, krijimi i një bordi këshillues mund të merret në konsideratë, e përbërë nga anëtarë të shoqërisë civile, si OJQ-të, gazetarët, studiuesit dhe përfaqësues të Kuvendit dhe Qeverisë. Bordi mund të asistojë Komisionerin për zhvillimin e praktikave të ndryshme ligjore apo realizimin më të mirë të objektivave të kësaj strategjie.

## 2.5 Sfidat

### 1. Transparenca në partneritetin publik-privat

Nevoja për transparencë në sektorin privat është duke u rritur në mënyrë të ndjeshme. Kontraktimi i shërbimeve publike me kompanitë e sektorit privat dhe organizata të tjera jo-publike ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme, nga kontratat relativisht të thjeshta në marrëveshje novatore, të cilat më parë konsideroheshin si funksione thelbësore të qeverisë. Është e nevojshme të sigurohet që ky zhvillim nuk do të çenojë transparencën gjatë rrugës. Ka një larmi zgjidhjesh të mundshme:

- masat proaktive të transparencës nëpërmjet standardeve të hapura kontraktuese;
- qeveria duhet të garantojë transparencën kur kontrakton shërbimet publike;
- ndryshimi i akteve të së drejtës për informim për të garantuar transparencë.

Konferenca e 10-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit, e shtatorit 2017, ka trajtuar këtë problematikë dhe ka miratuar rezolutën përkatëse.

Prandaj, rritja e transparencës në fushën e partneritetit publik-privat është një nga sfidat kryesore të Zyrës së Komisionerit.

### 2. Rritja e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike

Një nga sfidat kryesore të Zyrës së Komisionerit është rritja e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike duke rritur kontrollin mbi veprimtarinë e administratës publike në garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.

### 3. Garantimi i një sistemi efikas i të dhënave të hapura (*open data*)

Zbatimi i Direktivës për ripërdorimin e informacionit do të çonte në një progres substancial të të dhënave të hapura (Open Data) të qeverisë dhe të partneritetit për qeverisjen e hapur (Open Government Partnership), të cilat janë dy nga trendet globale. Shqipëria ka bërë përpjekje të rëndësishme në vitet e fundit për të qenë pjesë e këtij trendi. Sipas Open Data Barometer (OPB), Shqipëria renditet e 50-ta nga 115 shtete në mbarë botën. Për zhvillim të mëtejshëm të politikës së të Dhënave të Hapura të Shqipërisë në përputhje me strategjinë *Open Data* të BE-së është e një rëndësie të madhe qëndrimi në linjë me standardet ndërkombëtare relevante. Prandaj kontributi konkret i Zyrës së Komisionerit në unifikimin e standardeve të Open Data mbetet një nga sfidat e Zyrës së Komisionerit.

### III. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

#### 3.1 Situata Aktuale

Pas një eksperience disa vjeçare të funksionimit të Zyrës së Komisionerit, fusha e mbrojtjes së të dhënave personale ka patur një zhvillim në terma cilësore dhe praktikë.





Për vetë natyrën evoluese të kësaj fushe që ndjek risitë dhe zhvillimet teknologjike dhe shoqërore, lind nevoja e përmirësimit të akteve ligjore, monitorimit të vazhdueshëm, rritjes profesionale, trajnimit të stafit të Zyrës së Komisionerit, si dhe ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese pranë kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave personale.

Vizioni ynë mbetet i qartë, zhvillimi i vazhdueshëm dhe sensibilizimi i shoqërisë mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale.

Këto vite jemi munduar që të prekim fushat dhe sektorët më të rëndësishëm sa i përket sasisë, kategorive të të dhënave personale që përpunojnë dhe impaktit që kanë në privatësi. Është për t'u theksuar fakti që reagimi i kontrolluesve ka qenë pozitiv në tërësi duke ndërmarrë masat e nevojshme për të garantuar privatësinë në zbatim të detyrimeve ligjore përkatëse. Do të vijohet me monitorimin e mbrojtjes së privatësisë në përputhje tashmë edhe me zhvillimet më të reja në BE, siç është edhe rregullorja e re për mbrojtjen e të dhënave personale.

Indikatorët kryesorë matës të monitorimit të ligjit të mbrojtjes së të dhënave bazohen në statistika vjetore dhe krahasime të tyre, si vijon.


Duke i analizuar këto tregues referuar viteve 2014-2017 ndryshimet pozitive janë të dukshme.





### 3.2 Vizioni dhe Qasja

Sipas të njëjtës filozofi me qasjet strategjike në fushën e të drejtës për informim, si institucion me kompetenca për të monitoruar, hetuar dhe sanksionuar edhe në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, do të ndiqen të njëjtat qasje ndërgjegjësuere, parandaluese dhe sanksionuese.



Zyra e Komisionerit, do të demonstrojë profesionalizëm, kompetencë dhe ekspertizë në rolin si institucion mbikqyrës në garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, përfshirë këtu sektorin publik dhe atë privat. Siç parashikohet në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, do të trajtohen ankesat nga individët të cilët besojnë se të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale janë shkelur dhe do të kryhet hetimi i ankesave të tilla. Do të punohet në bashkëpunim me institucionet tona homologe në vendet e BE-së, dhe do të angazhohemi plotësisht në harmonizimin e legjislacionit aktual në fuqi me rregulloren e GDPR-së dhe direktivës së policisë. Kjo i shërben një qasjeje të re në të njëjtën frymë me institucionet homologe të Bashkimit Europian.

### 3.3 Objektivat

Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave personale është një fushë dinamike e cila është gjithmonë në zhvillim. Në këtë kuadër, në Maj të vitit 2018, hyn në fuqi rregullorja e BE-së 679/2016, “General Data Protection Regulation (GDPR)”, e cila do të zëvendësojë direktivën për mbrojtjen e të dhënave personale të vitit 1995. (Direktiva 95/46/EC). Rregullorja u miratua më 27 Prill 2016 dhe fillon efektet ligjore nga data 25 Maj 2018. Nëpërmjet kësaj rregullorje, Komisioni Evropian, synon të forcojë dhe unifikojë praktikatat e mbrojtjes së të dhënave personale për të gjithë individët brënda vendeve të BE-së.

Si një vend i cili aspiron integrimin në BE, vizioni i Zyrës së Komisionerit dhe disa nga objektivat për periudhën 3 vjeçare të zbatimit të strategjisë në kuadër dhe të hyrjes në fuqi të rregullores së GDPR-së janë:

1. Përshtatja e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me rregulloren 679/2016 e BE-së GDPR dhe direktivën e policisë 680/2016;
2. Rritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit në kuadër të harmonizimit të legjislacionit me *acquis*.
3. Bashkëpunim dhe partneritetet me homologët e vendeve të BE-së dhe institucionet shtetërore;
4. Mbrojtja e të dhënave në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
5. Njohja dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe kontrolluesve publik dhe privat mbi risitë e ligjit të ri të harmonizuar;
6. Edukimi i nxënësve me të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientet digjitale.

---

#### **Objektivi 1: Përshtatja e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me rregulloren 679/2016 e BE-së GDPR dhe direktivën e policisë 680/2016.**

Edhe pse GDPR-ja është rregullore, kompleksiteti i saj kërkon që të ndërmarrim hapat e nevojshme për ndryshimet legjislative në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e saj me kuadrin ligjor në fuqi. Qëllimi i GDPR-së është që të mbrojë privatësinë dhe shkeljet e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në një kohë kur përpunimi i të dhënave në kuadër të zhvillimeve teknologjike është shumëfishuar nga koha në të cilën është themeluar Direktiva e vitit 1995.

Megjithëse parimet kryesore të mbrojtjes së të dhënave janë akoma në përputhje me direktivat e mëparshme, shumë ndryshime janë propozuar për politikat rregullatore. Disa nga risitë që sjell kjo rregullore mbi mbrojtjen e të dhënave personale janë:

✓ **Zgjerimi i shtrirjes territoriale të efekteve të saj ligjore**

Ndoshta ndryshimi më i madh në peisazhin rregullator të mbrojtjes së të dhënave vjen me juridiksionin e zgjeruar të efekteve të GDPR-së. Më parë, aplikimi territorial i direktivës ishte i paqartë. GDPR e bën zbatueshmërinë e saj shumë të qartë. GDPR-ja do të jetë e zbatueshme për përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit që ndodhen në vendet e BE-së, pavarësisht nëse përpunimi kryhet apo jo në këto vende.

✓ **Forcimi i kriterëve për dhënien e pëlqimit**

Ka një qasje të re lidhur me konceptin e “pëlqimit” sipas GDPR-së. Në rregulloren e re trajtohen konkretisht aspektet praktike të pëlqimit dhe aspekte të tjera që lidhen me pëlqimin e të miturve ose pëlqimin me mjete elektronike.

✓ **Të drejtat e reja**

- *E drejta për t'u harruar* - “*Right to be forgotten*”: që do të thotë që subjekti i të dhënave ka të drejtën të kërkojë kontrolluesit të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të, pa vonesë, dhe kontrolluesi ka detyrimin të fshijë të dhënat personale, bazuar në shkaqet e parashikuara në Rregulloren e BE-së.
- *E drejta e transferueshmërisë së të dhënave* - *Data Portability*: Subjekti i të dhënave ka të drejtën të marrë të dhëna personale që ai ose ajo i ka dhënë kontrolluesit, në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm automatikisht dhe ti transferojë ato të dhëna tek një kontrollues tjetër pa pengesë.

✓ **Forcimi i llogaridhënies**

GDPR sjell një forcim të llogaridhënies në raport me përpunuesit e të dhënave. Kontrolluesit janë të detyruar të tregojnë më shumë vëmendje në respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtave në çdo fazë të përpunimit të të dhënave duke krijuar një kulturë të monitorimit, rishikimit dhe vlerësimit të procedurave të përpunimit të të dhënave apo dhe rritja e sanksioneve ndaj mos zbatuesve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

✓ **Rritja e transparencës**

Parimi i transparencës kërkon që çdo informacion që i drejtohet publikut ose subjektit të të dhënave të jetë konçiz, i aksesueshëm lehtësisht dhe i lehtë për t'u kuptuar dhe të përdoret gjuhë e lehtë dhe e qartë dhe përveç kësaj, sipas rastit, edhe vizualizim.

✓ **Mbrojtja e të dhënave të fëmijëve**

Fëmijët meritojnë mbrojtje specifike në lidhje me të dhënat e tyre personale, pasi ata mund të jenë më pak të ndërgjegjshëm për rreziqet, pasojat dhe garancitë përkatëse dhe të drejtat e tyre në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

✓ **Forcimi i pavarësisë së Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

GDPR garanton pavarësinë e plotë të Autoriteteve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke sugjeruar rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare.

✓ **Krijimi i rrjetit të Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave (DPO)**

GDPR sjell si risi detyrimin për caktimin e Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave të cilët duhet të caktohen me qëllimin për të vlerësuar nëse një organizatë kryen një përpunim të gjërë të të dhënave personale.

✓ **Certifikimi i kontrolluesve –përpunuesve të mbrojtjes së të dhënave**

Në zbatim të nenit 43 të Rregullores 2016/679, kërkohet certifikimi i kontrolluesve të mbrojtjes së të dhënave sipas kërkesës së tyre. Në këtë kuptim autoriteti mbikëqyrës duhet të ketë krijuar kushtet e nevojshme ligjore për:

- Hartimin dhe miratimin e aktit ligjor ose nënligjor “*Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*”;
- Akreditimin e organit certifikues;
- Certifikimin e kontrolluesve.

Qëllimi i këtij objekti është harmonizimi i të gjithë kuadrit ligjor ekzistues për mbrojtjen e të dhënave personale me praktikën më të mirë të EU në mënyrë që të garantohet kjo e drejtë. Sikurse vërehet, risitë që sjell rregullorja e GDPR janë të shumta. Edhe pse Shqipëria nuk është

pjesë e BE-se, si një vend që aspron integrimin, duhet të ndjekë trendin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire*.

Ky objektivi do të arrihet nëpërmjet:

- Analizës së kuadrit ligjor aktual për mbrojtjen e të dhënave personale dhe praktikave me qëllim identifikimin e mangësive në kuptim të harmonizimit me rregulloren e GDPR-së;
- Përgatitja e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- Konsultimi i projektligjit me palët e interesuara;
- Miratimi i projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, harmonizuar me rregulloren e GDPR.

Paralelisht do të punohet për përgatitjen e akteve nënligjore që burojnë nga miratimi i ligjit të ri (apo të amenduar).

---

## **Objektivi 2. Rritja e kapaciteteve të stafit të zyrës së komisionerit në kuadër të harmonizimit të legjislacionit me *acquis*.**

Nisur nga risitë që sjell rregullorja e GDPR-së, lind nevoja që paraprakisht të trajnohet stafi i Zyrës së Komisionerit sa i përket efekteve ligjore të saj dhe masave konkrete në praktikë të ndërmarra nga autoritetet homologe të BE-së.

Ky objektivi do të arrihet nëpërmjet një vlerësimi të kapaciteteve institucionale dhe operacionale të stafit të Zyrës së Komisionerit si dhe forcimit të kapaciteteve të stafit nëpërmjet trajnimeve.

Gjithashtu, një mundësi e mirë do të ishte zhvillimi i aktiviteteve trajnuese nëpërmjet instrumentit TAIEX, vizitat studimore pranë autoriteteve që kanë implementuar rregulloren e GDPR-së, nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe organizimi i aktiviteteve me interes të përbashkët (të karakterit inspektues, informues dhe sensibilizues) dhe shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave më të mira.

---

### **Objektivi 3: Bashkëpunim dhe partneritet me homologët e vendeve të BE, KE dhe institucionet shtetërore;**

Përafrimi i legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale me rregulloren e re të GDPR-së, kërkon edhe një bashkëpunim me partnerët homologë të vendeve të BE-së me qëllim transferimin e praktikave më të mira në këtë fushë.

Pjesëmarrja aktive në procesin e modernizimit të Konventës 108 të Këshillit të Evropës është një tjetër kontribut i rëndësishëm në këtë drejtim.

Krijimi i partneritetit strategjik ndërkombëtar në nivel rajonal dhe evropian është shumë i rëndësishëm në këtë kuadër pasi lehtëson në përshtatjen sa më të mirë të këtyre akteve në praktikë.

Ky objektivi do të arrihet nëpërmjet:

- Krijimit të partneritetit strategjik me agjencitë ligjzbatuese dhe institucionet e tjera, përfshirë sektorin gjyqësor, me qëllim përmirësimin e sistemit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Vizitave studimore në vendet e BE të cilët e kanë transpozuar rregulloren;
- Pjesëmarrje aktive në mbledhjet plenare të Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave dhe të Komitetit Konsultativ të Konventës 108 të KE;
- Pjesëmarrjen në Mbledhjet e Grupit të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit) dhe Seminarin e përvitshëm të Shqyrtimit të Praktikave (*Case Handling Workshop*);
- Vijimin e kontakteve me institucionet homologe në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave.

---

### **Objektivi 4. Mbrojtja e të dhënave në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit**

Teknologjia digjitale është një katalizator i jashtëzakonshëm për të gjitha format e shprehjes sociale dhe ndryshimeve sociale. Teknologjia e avancuar duhet të ecë paralelisht me reagimin e çdo kontrolluesi për më shumë siguri dhe mbrojtje të të dhënave personale. Mënyra se si duhet të reagohet për ndryshim të shpejtë për shkak të kërcënimeve ndaj sigurisë, do të ketë

pasoja për ne dhe brezat e ardhshëm që të trashëgojnë botën digjitale. Për të përfituar nga teknologjitë e reja dhe ruajtur të drejtat e individit, Zyra e Komisionerit ka për qëllim të jetë një epiqendër për ide kreative dhe zgjidhje të reja.

Fenomenet globale të cloud computing dhe big data janë bërë më urgjente se kurrë.

Organizatrat, kompanitë dhe autoritetet publike që merren me të dhënat personale janë përgjegjës për mënyrën se si mblidhet ky informacion, shkëmbehet dhe ruhet, pavarësisht nëse këto vendime janë marrë nga njerëzit ose algoritme.

Në funksion të këtij qëllimi, Zyra e Komisionerit do të kryejë veprimet e mëposhtme për arritjen e këtij objekti:

- Do të promovojë tek kontrolluesit pritshmëritë pozitive që ata do të kenë pas aplikimit dhe përfitimit të Certifikimit mbi pajtueshmërinë e sistemeve të përpunimit të të dhënave me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave;
- Do të promovojë teknologji (by design) për të rritur privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave;
- Do të synojë të arrijë krijimin dhe administrimin e databazave për të monitoruar veprimtaritë e kontrolluesve që përpunojnë të dhëna në mënyrë elektronike;
- Do të përmirësojë metodologjinë për inspektimet në veçanti me synim përfshirjen e një metode më të efektshme për inspektimin e sistemeve të IT;
- Bashkëpunim me institucionet shtetërore përgjegjëse për sigurinë kibernetike me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale gjatë lundrimit në internet.

---

### **Objektivi 5: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe kontrolluesit publik dhe privat mbi risitë e ligjit të ri të harmonizuar**

Një element shumë i rëndësishëm i cili duhet të mbahet parasysh pas harmonizimit të kuadrit ligjor në fuqi me rregulloren e GDPR-së dhe direktivën, është edhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe kontrolluesëve publike dhe privat në lidhje me informimin e tyre për sa i përket risive që sjell ligji i harmonizuar.

Ndërgjegjësimi i publikut dhe njohja e tij me ndryshimet që sjell kjo rregullore është po aq i rëndësishëm sa dhe vetë miratimi i tij. Njohja e publikut me risitë që sjell ky ligj e bën më të thjeshtë zbatimin e tij. Për këtë arsye Zyra e Komisionerit do të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme me qëllim realizimin e këtij objekti:

- Organizim të trajnimeve në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Vëmëndja do të fokusohet te trajnimet pasi njohja e kontrolluesit publik me të drejtat dhe detyrimet si dhe risitë që sjell rregullorja (GDPR) dhe direktiva është hapi i parë i cili garanton zbatueshmërinë e tij në praktikë;
- Organizimit të tryezave dhe takimeve me kontrolluesit privatë duke i grupuar sipas sektorëve përkatës në lidhje me ndryshimet e reja ligjore;
- Një ndër elementët e reja që sjell rregullorja sikurse është përmendur edhe më lart, është krijimin e rrjetit të Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave (DPO). Në këtë kuadër do të zhvillohen trajnime të cilat do të fokusohen tek burimet e reja njerëzore që do të angazhohen në funksionet e oficerit të mbrojtjes së të dhënave dhe ekspertët e mbrojtjes së të dhënave;
- Sensibilizimit në media përfshirë dhe median sociale;
- Publikimit të broshurave, komentareve dhe manulëve mbi risitë e ligjit të harmonizuar.

---

## **Objektivi 6: Edukimi i nxënësve me të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientet digjitale**

Në epokën digjitale, edukimi i përgjegjshëm, etik dhe i civilizuar në përdorimin e teknologjive të reja është një prioritet, veçanërisht për nxënësit në shkolla. Një komponent kryesor i edukimit digjital është adresimi i mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

Objektivat që duhen arritur janë: Përvetësimi i njohurive mbi të drejtat dhe përgjegjësitë në ambientet digjitale, zhvillimi i aftësive të të menduarit kritik tek të rinjtë për përdorimin e të dhënave personale dhe aftësimi i mësuesve në mënyrë që fëmijët të lundrojnë në mjedisin digjital me besueshmëri, kthjelltësi dhe respekt për të drejtat e çdokujt.

Në përmbushje të këtij objekti, Zyra e Komisionerit e shikon si tejet të rëndësishëm vazhdimin e bashkëpunimit strategjik me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mësuesit, nxënësit, prindërit dhe të gjithë atyre organizatave jo fitim prurëse që kanë në fokus të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.



## 3.4 Sfidat

### 1. Identifikimi i praktikave më të mira dhe trajnimet

Një nga sfidat kryesore në zbatimin e objektivave të parashikuara në fushën për mbrojtjen e të dhënave personale, është vështirësia me të cilën do duhet të përballlet stafi i cili do të punojë për harmonizimin e legjislacionit aktual në fuqi me rregulloren e GDPR-së.

Duke qënë se vetë rregullorja, është një rregullore e re e cila hyn në fuqi në Maj të këtij viti, kapacitetet për të marrë eksperiencat dhe praktikat me të mira të vendeve të BE-së që e kanë implementuar atë, janë të pakta, duke qënë se vetë harmonizimi nga këto vende do të kryhet në po të njëjtën kohë.

Mungesa e një stafi të trajnuar me risitë që sjell kjo rregullore me qëllim përshtatjen sa më të mirë me kuadrin ligjor në fuqi do të kërkojë një angazhim maksimal nga Zyra e Komisionerit.

### 2. Krijimi i kulturës së mbrojtjes së privatësisë në ambientet digjitale

Përdorimi i të dhënave personale në ambientet digjitale po zhvillohet në mënyrë eksponenciale në Shqipëri. Krijimi i databazave elektronike, vënia në punë e software-ve më komplekse për përpunimin e të dhënave, përdorimi i telefonave smartphone dhe tablet nga të gjitha moshat, nëse nuk ka mbrojtje proaktive të të dhënave personale, krijon një shoqëri vunerabël për sa i përket cënimit të privatësisë. Një shoqëri e ndërgjegjësuar për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale është një shoqëri që merr hapa aktive për të mbrojtur të dhënat nga cënime të mundshme qofshin këto nga rrjedhja e të dhënave, sulme kibernetike apo dhe thjesht pakujdesia.

Këto masa kanë të bëjnë në radhë të parë me edukimin e fëmijëve në moshën shkollore për mbrojtjen e privatësisë, edukimin e studentëve dhe specialistëve me parimet e privacy by design dhe privacy by default si dhe ndërgjegjësimi i gjithë shoqërisë shqiptare me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Krijimi i kësaj kulture gjithpërfshirëse për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në ambientet digjitale është një nga sfidat që Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të ballafaqohet në vitet në vijim.

## IV. VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE

Zyra e Komisionerit ka një aktivitet të vazhdueshëm dhe bashkëpunim të gjërë me organizatat ndërkombëtare me të njëjtin fokus si dhe me institucionet homologe në vendet e rajonit dhe më gjerë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe përshtatjen e risive në fushën e veprimtarisë së saj. Rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar, materializohet dhe me faktin se Zyra e Komisionerit do të jetë mikpritëse e dy konferencave ndërkombëtare më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Për herë të parë në Shqipëri do të organizohen:

### **1. Konferenca Evropiane 2018 e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale**

Zyra Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të organizojë në 3 – 4 Maj 2018, edicionin e rradhës të Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave. Ky është forumi më i lartë dhe më i rëndësishëm në këtë fushë me pjesëmarrje edhe të institucioneve si Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës.

Organizimi i këtij eventi për herë të parë në vendin tonë është shprehje e vlerësimit të aktivitetit dhe punës të Zyrës së Komisionerit, me qëllim ndërtimin dhe forcimin e rrugëve të bashkëpunimit në mbrojtje të privatësisë së individit. Në këtë forum diskutohen e promovohen praktikat dhe eksperiencat më të mira, për krijimin e standardeve më të larta në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me të dhënat personale.

Vendi organizator i Konferencës bëhet automatikisht anëtar i Komitetit të Akreditimit të saj.

Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave është zhvilluar për herë të parë në Hagë të Hollandës në vitin 1991. Pjesëmarrësit e këtij edicioni hodhën themelet e një diskutimi gjithëpërfshirës për forcimin e kuadrit ligjor evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Në më shumë se dy dekada, është rritur mjaft numri i Autoriteteve anëtare në Konferencë, aktualisht numërohen 62 të akredituara me të drejta të plota dhe 6 me statusin e vëzhguesit. Zyra e Komisionerit është anëtarësuar në këtë forum prej vitit 2010.

## **2. Konferenca Botërore 2019 e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale**

Shqipëria do të mirëpresë Konferencën Botërore të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë në vitin 2019. Komiteti Ekzekutiv i Konferencës ka shpallur Shqipërinë si vendin fitues për të organizuar eventin më të rëndësishëm të autoriteteve dhe të ekspertëve të mbrojtjes së të dhënave personale, pas Hong Kongut në vitin 2017 dhe Belgjikës në vitin 2018.

Konferenca Botërore e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë “Tirana 2019” do të zhvillohet në periudhën shtator-tetor 2019.

Konferenca botërore organizohet për herë të parë në Ballkanin Perëndimor. Zhvillimi i saj në Tiranë është vlerësim edhe për përpjekjet e vendeve të rajonit tonë në ndërtimin e shoqërive demokratike dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Konferenca Ndërkombëtare është themeluar në vitin 1979 dhe aktualisht, numëron 114 Autoritete kombëtare dhe rajonale anëtare. Gjatë Konferencës diskutohen e promovohen praktikrat dhe eksperiencat më të mira nga Autoritetet, ekspertë, studiues e profesionistë të fushës për të unifikuar standardet në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Ne do të komunikojmë në mënyrë të qartë dhe efektive me palët tona të interesit në lidhje me aktivitetet tona duke përdorur metodat më të përshtatshme dhe efikase të komunikimit përfshirë këtu faqen zyrtare të internetit, mjetet e medias sociale ose nëpërmjet angazhimit të drejtpërdrejtë.

## V. MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA

Zbatimi efikas dhe me sukses i Strategjisë për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2018 – 2020, do të sigurohet nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të kontrolluar nëse objektivat e përcaktuara në strategji janë realizuar.

I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të udhëhiqet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërsa monitorimi i zbatimit të objektivave në nivel teknik do të kryhet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i cili do të mbledhet një herë në 4 muaj.

Informacioni periodik lidhur me ecurinë e zbatimit të objektivave i diskutuar në takimet e GMS do të paraqitet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë kuadër do të hartohen edhe raporte monitorimi vjetore të cilat do të paraqesin progresin e zbatimit të objektivave të strategjisë.

Këto raporte monitorimi do të shërbejnë edhe si një udhërrëfyes për të identifikuar risqet të cilat çojnë në mosrealizimin e plotë të objektivave dhe nevojën për burime financiare. Ky parashikim do të ndihmojë në vlerësimin e nevojave financiare, dhe jo vetëm, për realizimin e objektivave të strategjisë për periudhën në vijim, duke orientuar kështu programin e burimeve financiare në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesem si dhe në uljen e risqeve për zbatimin e strategjisë në vijim.

Plani vjetor i punës së Zyrës së Komisionerit hartohet në përputhje me objektivat e strategjisë të cilat do të zbërthehen në aktivitete konkrete afatshkurtër. Progresi i tyre do të monitorohet në përputhje me afatet dhe rezultatet e parashikuara në planin e punës.

Me qëllim menaxhimit të riskut i cili përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave, aneksi i këtij dokumenti është edhe strategjia e menaxhimit të riskut.

## **Transparenca dhe informimi i publikut**

Zyra e Komisionerit do të prodhojë raport vjetor të zbatimit të strategjisë të cilat do të publikohen si pjesë e raportit vjetor të Zyrës së Komisionerit.

Përveç monitorimit të kryer nga vetë Zyra e Komisionerit, ftohen në monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe rezultateve të saj edhe grupet e interesit.

## **VI. FINANCIMI I STRATEGJISË**

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen në vija të përgjithshme të burimeve financiare që financojnë Strategjinë për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2018 – 2020.

Financimi i strategjisë do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit i akorduar për Zyrën e Komisionerit për vitet 2018 – 2020 si dhe nga mbështetja financiare e donatorëve.

Rritja e buxhetit do të ndihmojë në realizimin e plotë të objektivave.